



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KRYETARI KËSHILLIT

Nr. 22311 Prot

Gramsh më 05.06 2021

VENDIM  
Nr. 87 dt. 29/06/2021  
Për

**“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Hasan Ajazi, banor në fshatin Shëmrizë, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Hasan Ajazi**, banor në fshatin Shëmrizë, Njësia Administrative Pishaj, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **553 906 x 50% = 276 953** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Hasan Ajazi** është në **276 953** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **276 953** (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë **Z. Hasan Ajazi**.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori i Emergjencave Civile ).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini  
Pranoi: G. Lena  
Miratoi: G. Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

GRETA LENA

